

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Arkëtar pranë FSHU sha.**

ARKËTAR

Arkëtari është përgjegjës për kryerjen e arkëtimeve të faturave të energjisë, duke siguruar korrektësi dhe përpikmëri në procesin e pagesave. Ai vulos dhe firmos shumën e paguar, raporton arkëtimet ditore sipas kategorive të përcaktuara dhe kryen derdhjen e tyre në bankë. Gjithashtu, ai përditëson pagesat në sistem dhe bashkëpunon me llogaritarin për të siguruar saktësinë e të dhënave financiare.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbaton me korrektësi orarin e veprimeve të arkës.
- Kryen arkëtimin e faturave koherente ose debitore.
- Zbaton me korrektësi veprimet e pagesës së energjisë për secilin klient.
- Bën vulosjen dhe firmosjen për shumën e paguar nga klientët, pasi ai ka kryer pagesën.
- Kryen me saktësi raportimin ditor të arkëtimeve sipas kategorive të përcaktuara.
- Bën derdhjen çdo ditë të arkëtimeve në sportelet e bankës duke paraqitur mandatin e bankës si provë të pagesës.
- Bën çdo ditë azhurnimin e pagesave në bazë të mandatit të bankës, kundra faturave dhe shiritit të regjistrimit të veprimeve ditore (strico) me llogaritarin e parë (evidence për nivelin e arkëtimeve ditore).
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm.
- Të ketë eksperiencë pune.
- Të mos ketë rekorde kriminale.
- Orientim të fortë drejt nevojave të klientit.
- Të ketë njohuri për programet bazë të kompjuterit.

Dokumentat për dorëzim:

- Curriculum Vitae (CV).
- Letër Interesi – në të cilën duhet të specifikohen arsyet të cilat ju mendojnë se ju bëjnë një kandidat potencial për këtë pozicion.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.